



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 12 tetor 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Skender Hyseni, Donika Kadaj- Bujupi, Amir Ahmeti.

Munguan: Enis Kervan, Shaip Muja, Sabri Hamiti, Petar Miletiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- ZPRK, Shefki Kastrati-NDI, Isuf Zejna-KDI, Sanije Berisha-OSCE.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 23 shtator 2011;
3. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-207 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 23 shtator 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 23 shtator 2011.

3. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-207 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;

Albin Kurti- njoftoi se grupi punues i Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-207 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, i ka ndërmarrë aktivitetet e parapara për mbikëqyrjen e tij, dhe e ka hartuar këtë raport me disa rekomandime, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij Ligji.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-207 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe i njëjti i procedohet mbledhjes plenare për shqyrtim

4. Të ndryshme

1. Kryetari i Komisionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri tha se është përgatitur Njoftimi i cili sipas nenit 75 të Rregullores së Kuvendit, i procedohet Kryesisë dhe deputetëve të Kuvendit.

Amir Ahmeti tha se në diskutimin e tij në tekstin e Njoftimit nga vizita, fjalët për “përkatësin e tij partiake” duhet zëvendësuar me fjalët “profilin politik të partisë së tij”.

Hydajet Hyseni njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me vizitën e realizuar në Kanada, si pjesë e delegacionit të Kuvendit, kohëzgjatjen e saj, efektet e kësaj vizite dhe pritjen shtetërore që i është bërë delegacionit.

2. Kryetari i Komisionit njoftoi se Nënkomisioni për Mandate Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës, është në procedurë të hartimit dhe ndryshimit të Rregullores së Kuvendit dhe i ka rekomanduar të gjitha komisioneve të Kuvendit që të bëjnë përshkrimin e fushëveprimtarisë së tyre dhe brenda dy javëve t’ia përcjellin këtij nënkomisioni.

Pas diskutimeve të deputetëve, Komisioni vendosi që rekomandimi i Nënkomisioni për mandate imunitete dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me fushëveprimtarinë e Komisionit për Punë të Jashtme, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

